



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA DEVOLL
NJESIA E PROKURIMIT**

Nr. _____ Prot

Bilisht, më 24.07.2023

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Shërbimi i Pastrimit per Bashkine Devoll”

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Shërbime
pastrimi 98341130-5**

**VLERA E FONDIT LIMIT: 97 242 575.2 (nentedhjete e shtate milion e dyqind e dyzet e dy mije
e peseqind e shtatedhjete e pese pike dy) lek pa t.v.sh ose 967 106.6 (nenteqind e gjashtedhjete
e shtate mije e njeqind e gjashte pike gjashte) euro**

**Llogaritja ne Euro eshte bërë sipas kursit zyrtar i këmbimit të Bankës së Shqipërisë në datën
24.07.2023 ,i cili është 100,55 Lekë/Euro**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit
78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,
autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Devoll** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin
e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si
më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

b. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr.
285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.1.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare **2020,2021,2022**, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se jo më e vogël se vlera e përlllogaritur e fondit limit të kontratës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Ky kriter i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës, prandaj është kërkuar që vlera e xhiros të jete sa vlera e përlllogaritur e fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin 43 pika 2/a të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar dhe nenin 77 pika 3 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43 pika 1 e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, në zbatim të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

2.1.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare **2020,2021,2022**, të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të Ligjit nr.10091, date 05.03.2009 ”Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” i ndryshuar, Kreu V, neni 41, pika c, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi:Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin

29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës **31 mars të vitit pasardhës**, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji.

Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, është bërë duke iu referuar parashikimit në nenin 41 shkronja c” të Ligjit nr. 1009/2009: “Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shumën e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël”.

2.1.3 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një dokument që vërteton se ka plotësuar të gjitha **detyrimet e taksave dhe tarifave vendore**, lëshuar nga Pushteti Vendor, **për vitin 2022 ose keestet e maturuara për vitin 2023** referuar ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, si dhe sipas Vendimit të Këshillit Bashkiak përkatës ku subjekti ushtron aktivitetin, lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë këtë dokument në momentin e dorëzimit të dokumentave).

Ky kriter do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, që OE i ka shlyer detyrimet e taksave dhe të tarifave vendore, do të dorëzohet vetëm nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4, e LPP, si dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Vendosja e kërkesës për detyrimet vendore është bërë në mbështetje të Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar. Shlyerja e detyrimeve vendore për operatorët ekonomik pjesëmarrës vërteton se ushtrojnë aktivitetin e tyre ekonomik në përputhje me rregullat e përcaktuara nga autoritetet vendore nëpërmjet Vendimeve të Këshillave Bashkiak.

2.2 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.2.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes të njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit të limitit të kësaj kontrate .

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara. Në rastet kur në

faturat tatimore nuk përfshihen të gjitha zërat e shërbimeve, ato duhet të shoqërohen me situacionet ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara

- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara. Në rastet kur në faturat tatimore nuk përfshihen të gjitha zërat e shërbimeve, ato duhet të shoqërohen me situacionet ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin 41, pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar

2.2.2 Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, operatorët ekonomikë duhet të jenë të pajisur me licencat/lejet të lëshuara nga Qendra Kombëtare e Licensimit me;

- a. Leje mjedisore me Kod III.1.A të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit me objekt stacion transferimi.
- b. Licensë e lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit për Ndikimin në Mjedis (kodi III.2.A)
- c. Licensë e lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit për transportim të mbetjeve jo të rrezikshme (kodi III.2.B)
- d Licensë e lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit pastrim, larje kontenierësh (kodi III.1.A)
- f. Licensë e lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit për shërbime ndërhyrëse higjieno-shëndetësore (dezinfektim).

Argumentimi : Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në piken 2, te nenit 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, “Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë” dhe nenin 41, pika 4, gërma a.) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar , të ligjit nr.10081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, VKM Nr. 538, datë 26.05.2009, “Për Licencat dhe Lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta” e ndryshuar, Ligjin Nr. 10 463, datë 22.9.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar, Ligji nr. 10 431, date 9.6.2011”Per mbrojtjen e mjedisit” Ligjin Nr 10448, datë 14.07.2011, “Për Lejet e Mjedisit”,Ligji

95/2015, Udhëzim i Ministrisë të Shëndetësisë nr. 184 dt. 16. 6. 1998, "Kërkesa për ushtrimin e aktivitetit privat për shërbimet DDD";

Me anë të këtyre kriterëve kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente.

2.2.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e shërbimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor, si më poshtë:

Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, operatorët ekonomikë duhet të kenë stafin e tyre teknik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Për të përmbushur këtë kapacitet operatorët ekonomikë duhet të përcaktojnë me deklaratë të vecantë Drejtuesin Teknik të shërbimit të pastrimit, me eksperiencë pune mbi 5 vjet dhe i listuar në Listëpagesat e operatorit ekonomik gjatë periudhës Janar- Qershor 2023. Dokumentacioni i nevojshëm për të provuar këtë është kontratë pune e vlefshme, librezë e punës, diploma, CV, çertifikatë e lëshuar nga Ministria e Mjedisit për Vlerësimin e Ndikimit.

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetdeklarimit sipas shtojcës 9 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar "Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j" të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin".

Argumentimi: "Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në piken pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës" dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik". i ndryshuar Drejtuesi Teknik i shërbimit të pastrimit është përgjegjës për zbatimin e këtij shërbimi në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës. Duke ju referuar zerave të preventivit dhe specifikimeve teknike të tij, është shumë e rëndësishme për AK kapaciteti dhe përvoja e mëparshme në punë e drejtuesit teknik të këtij shërbimi që vertetohen në CV perkatëse të tij.

Kriteri I mesipër për eksperiencën e drejtuesit teknik është në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese për operatorët.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, projektin, relacionet dhe raportet teknike, specifikimet dhe zërat e shërbimit që do të realizohen dhe do të monitorohen në vazhdimësi nga ky lloj inxhinieri. Nevoja për Drejtuesin teknik me çertifikatë të lëshuar nga Ministria e Mjedisit për Vlerësimin e Ndikimit në objekt është e diktuar nga përvoja e mëparshme, legjislacioni për mjedisin rekomandimeve të APP dhe vendimeve të KPP në lidhje me këto kriter me arsyetimin për mos të

ngushtuar konkurrencen. Eshte vendosur periudhës Janar- Qershor 2023 pasi konsiderohet e mjaftueshme qe ofertuesi te vertetoje qe ka nje vazhdimesi ne aktivitetin e perditshem dhe angazhimin e struktures se stafit drejtues.

2.2.4 Përveçse sa më sipër, OE duhet të disponojë gjithashtu një punonjes I cili të disponojë dëshmi të kualifikimit profesional/diploma/certifikata trajnimi nga një organizëm i akredituar/licencuar /certifikuar shqiptar ose i huaj për 1(një) inxhinier i specializuar për sigurimin teknik dhe shëndetin në punë sipas kërkesave të ligjit nr. 10237 date 18.02.2010 “Per sigurine dhe shendetin ne pune” dhe V.K.M. nr. 312, date 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”, I cili duhet te jetë i listuar në Listëpagesat e operatorit ekonomik gjatë periudhës Janar- Qershor 2023.

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetdeklarimit sipas shtojcës 9 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin

Argumentimi: “Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Ligjin nr. 10237 date 18.02.2010 “Per sigurine dhe shendetin ne pune” dhe V.K.M. nr. 312, date 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier” piken 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.i ndryshuar

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates pasi sipas specifikimeve teknike dhe grafikut të punimeve projektit dhe relacioneve punime do te kryhen edhe gjate orëve të para të mëngjesit por edhe gjatë mbrëmjes sipas nevojave do të jetë e domosdoshme prania e nje inxhinieri te specializuar i cili do te trajnoje punonjësit qe do të jene ne teren dhe do të marre masa per instruktimin e sigurimit teknik. Eshte vendosur periudhës Janar 2023 –Qershor 2023 pasi konsiderohet e mjaftueshme qe ofertuesi te vertetoje qe ka nje vazhdimesi ne aktivitetin e perditshem dhe angazhimin e struktures se stafit drejtues.

2.3.5 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin gjithashtu pranë Autoritetit Kontraktor kontratë të vlefshme pune dhe certifikatë përkatëse të lëshuar nga Ministria e Punëve të Brëndshme, Drejtoria PMZSH për 1 (një) specialist ekspert zjarrëfikës në fushën e mbrojtjes nga zjarri, I cili duhet te jetë i listuar në Listëpagesat e operatorit ekonomik gjatë periudhës Janar- Qershor 2023.

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetdeklarimit sipas shtojcës 9 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese

të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar sipas kërkesave të ligjit nr. 152/2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin” piken 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” *Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës*” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.i ndryshuar

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Ak vlereson si të nevojshëm praninë e një eksperti zjarrëfikës i cili kryen trajnime në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin pasi mund të ndodhin incidente nga mbetje të rrezikshme që mund të depozitohen në kontenerët apo në stacionin e depozitimit si dhe ndonjë zjarrvënie e qëllimshme.

2.3.6 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin gjithashtu:

Kontratë pune të vlefshme dhe diplomë për 1(një) inxhinier mekanik me eksperiencë pune mbi 5 vjet. Operatori ekonomik duhet të jetë I pajisur me leje të lëshuar nga QKL kodi III.1.A (riparim I pajisjeve motorrike dhe motocikletave).

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetdeklarimit sipas shtojcës 9 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

Argumentimi: Ky kriter është përcaktuar bazuar në piken pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” *Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës*” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar

Me këte kriter Autoriteti Kontraktor vlereson si të domosdoshëm shërbimin e pastrimit në kohe dhe me cilesi pasi gjatë punimeve mund të ndodhin dëfekte makinerive që do të jene në dispozicion të kontrates dhe prania e një inxhinieri mekanik ose një kontratë e vlefshme shërbimi dhe leje të lëshuar nga QKL kodi III.1.A (riparim I pajisjeve motorrike dhe motocikletave) do të sigurojë autoriteti kontraktor që

shërbimi nuk do të ketë vonesa edhe sipas specifikimeve teknike (vonesa më e gjatë jo më shumë se 3 orë).

Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët. Numri i stafit kryesor është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e shërbimit. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

2.3.7 Operatorët ekonomikë, për të vërtetuar se punët, objekt prokurimi, I plotësojnë kërkesat e cilësisë, duhet të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, I akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Konkretisht:

1. ISO 9001:2015 (Standard për Sistemin e Menaxhimi të Cilësisë)/ekuivalente dhe e vlefshme
2. ISO 14001:2015 (Standard për sistemin e menaxhimit të mjedisit)/ekuivalente dhe e vlefshme
3. OHSAS 18001 (Standard për manaxhimin e rreziqeve rreth shëndetit dhe sigurimit në punë)/ekuivalente dhe e vlefshme
4. ISO 39001 (Standard për sistemin e menaxhimit të sigurisë rrugore)/ekuivalente dhe e vlefshme

Argumentimi: Kriteret e mesiperme janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 79, pika 1 ku citohet se: *“Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”*, si dhe në zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku përcaktohet se: *“Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”*.

Për vete natyrën e veçantë, vendndodhjes dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurohet, është tepër e rëndësishme që operatorët të kryejnë shërbimet dhe realizojnë objektin e kontratës me standardet e kërkuara të cilësisë. Sistemi i menaxhimit të cilësisë dhe të mjedisit janë standarde që çdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arritjen e suksesit. Këto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit përgjegjës për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës.

Kriteri I mesiperme për paraqitjen e certifikatave ISO është në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese për operatorët.

Për ISO 9001 – 2015 ose ekuivalente; Kjo çertifikate specifikon kërkesat për një sistem të menaxhimit të cilësisë, ku një operator ekonomik duhet të tregojë aftësinë e tij që vazhdimisht të sigurojë punë/mallra ose shërbime që plotësojnë kërkesat e aplikueshme ligjore dhe rregullatore, si dhe synon të rrisë kënaqësinë e konsumatorit nëpërmjet zbatimit efektiv të sistemit duke përfshirë edhe proceset për përmirësim të vazhdueshëm të sistemit dhe sigurimin e konformitetit të klientit dhe kushtet e aplikueshme ligjore dhe rregullatore si dhe meqënëse **Bashkia Devoll** si Autoritet Kontraktor kërkon që shërbimet që do të kyhen të jenë në cilësinë më të lartë është përcaktuar që kandidatët ofertues të jenë të pajisur me këtë standart cilësie.

Për ISO OHSAS 18001 ose ekuivalente: Ky standart përcakton kërkesat minimale të shëndetit në punë dhe praktikatat më të mira të menaxhimit të sigurisë. Ky lloj standarti konsiston në sigurimin e një sistemi shëndetësor optimal dhe menaxhimin e sigurisë në punë. Kjo mund të ndihmojë për të vënë në vend politikat, procedurat dhe kontrollat e nevojshme për çdo lloj biznesi për të arritur kushtet më të mira të mundshme të punës, një linjë me praktikën më të mirë të njohur ndërkombëtare.

Per ISO 14001 – 2015: ose ekuivalente Eshtë kërkuar që kandidatët ofertues të jenë të pajisur me standartin ISO 14001 – 2015 , standart ky që vlerëson sipas përkufizimit të tij përgjegjshmërinë e kompanive ndaj mjedisit dhe fokusohet në tre fusha kryesore:

- Standardet e Sistemit të Menaxhimit - që vlerësojnë nivelin e sistemit të zhvillimit dhe integritetit të përgjegjësive ndaj mjedisit në të gjithë kompaninë,
- Standardet Operative - që masin harxhimin e burimeve natyrore dhe energjisë në proceset operative të kompanisë, dhe
- Standardet e Sistemit të Mjedisit - që masin ndotjet e ndryshme nga mbetjet.

Bashkia Devoll si Autoritet Kontraktor kërkon një manaxhim të aktivitetit përkushtuar parandalimit të ndotjes dhe të përmirësimit të ndikimeve mjedisore.

Për ISO 39001 (Standard për sistemin e menaxhimit të sigurisë rrugore)/ekuivalente Ky Standart përcakton kërkesat minimale për një Sistem të Menaxhimit të Sigurisë së Trafikut Rrugor. Ky lloj standarti konsiston në sigurimin e një sistemi të sigurt të trafikut rrugor gjatë kryerjes të shërbimeve.

2.3.8 Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi për fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.. Për të përmbushur këtë kapacitet operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

Vërtetim për fuqinë mesatare punëtore për mesatarisht 50 (pesëdhjetë) punonjës për periudhën Janar-Qershor 2023, I lëshuar nga Administrata Tatimore.

Listpagesat, sipas formatit të miratuar nga Administrata Tatimore, për Janar- Qershor 2023.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetdeklarimit sipas shtojcës 9 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

Argumentimi: “Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/c dhe 6 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Numri i punonjësve është përcaktuar bazuar në volumet dhe orët e punës që duhen për të përmbushur zbatimin e kontratës. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë tregon besueshmëri për autoritetin. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë totale punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë çdo dëshmi me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve dhe përvojën e tyre, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve. Vendosja e kriterit për një punësim të paktën 50 persona është në përputhje me volumin e punës, natyrën dhe terrenin ku do të kryhen shërbimeve si dhe VKM për kohën e punës në muaj për punonjes. Po t’i referohemi preventivit, VKM, relacionit, matjeve përkatëse që janë bërë është plotësisht i justifikuar numri i punonjësve. Në qoftë se shërbimi i fshirjes do të kryhet 1 ditë gjatë vitit në të gjitha sipërfaqet e cituara në preventivin e punimeve, numri i personave që do të fshihen është rreth 32 punonjes, duke përfshirë këtu edhe numrin e shoferave dhe operatorët e mjeteve grumbulluese pra (10 punonjes), 2 shoferë për kamioncinën dhe autobotin për larjen e rrugëve dhe shesheve, një manovrator për drejtimin e mjetit tip fadrome si dhe stafin drejtues që e kemi përmendur më sipër, numri total i kalon 50 punonjes që AK ka kërkuar për këtë shërbim. Kriteri për kualifikim është vendosur që t’i shërbejë autoritetit për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë, kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Gjithashtu për të vërtetuar zotërimin e fuqisë punëtore si dhe stabilitetin e saj është kërkuar edhe vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore si dhe listpagesat e punonjësve për periudhën e kërkuar më sipër.

2.3.9 Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion për të përmbushur kontratën. Konkretisht:

1. Makinë teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës jo më pak se 10 ton, raport kompaktimi 1:4 - 1:6, jo më pak se **1 (një) copë**;
2. Makinë teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës 5-8 ton, raport kompaktimi 1:4 - 1:6, jo më pak se **4 (kater) copë**;

3. Makina për larjen e rrugëve, (autobot) i pajisura me pompë për larjen e rrugëve me presion, me dy ose më shumë pjata larëse në pjesën e përparme, me kapacitet mbajtës jo më pak se 10,000 litra ujë, jo më pak se **1(një) copë**;
4. Kamioncine 3-5 ton **1 (një) copë**.

Gjithashtu OE duhet të disponojë mjetet rezervë :1. Makinë teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës jo më pak se 10 ton, raport kompaktimi 1:4 - 1:6, 1 (një) copë.

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetdeklarimit sipas shtojcës 9 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin”.

Për mjetet që shënohen në regjistra publike duhet të paraqitet leja e qarkullimit, çertifikata e pronësisë, çertifikata e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit, taksat vjetore dhe foto perkatëse ku të jetë e dukshme targa e mjetit dhe karakteristikat e tij.

Për mjetet që shënohen në regjistra publike që merren me qira të paraqitet kontrata noteriale e qirasë e vlefshme gjatë gjithë afatit të realizimit të kontratës objekt prokurimi. Bashkangjitur kontratës së qirase duhet të paraqitet leja e qarkullimit, çertifikata e pronësisë, çertifikata e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit, taksat vjetore dhe foto perkatëse ku të jetë e dukshme targa e mjetit dhe karakteristikat e tij.

Argumentimi: “Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Referuar përcaktimeve të Vkm 319 date 31.05.2018” Per miratimin e masave për kostot e menaxhimit të integruara të mbetjeve” Kamionët tipikë për grumbullimin e mbetjeve janë vetëngjeshës me kapacitet 5 dhe 10 tonë. Këta kamionë sugjerohen për t’u përdorur në varësi të tipologjisë së njësisë. Normalisht, në një zonë rurale apo rrugë të ngushta urbane përdoret një kamion me kapacitet 5 tonë, ndërsa në një zonë urbane një tip kamioni me kapacitet 10 tonë. Numri i kamionëve varion bazuar në sasinë e mbetjeve për t’u mbledhur dhe numrin e turneve të nevojshme për çdo kamion. Kapaciteti aktual i ngarkimit për një përbërje mikse mbetjesh është rreth 85% të kapacitetit total mbajtës të kamionit (p.sh., një kamion 10 tonësh mbushet deri në 85%) si dhe sasise se gjeneruar të mbetjeve në ditë dhe frekuences se rumbullimit

- Ne qytetin e Bilishtit bazuar ne numrine popullsise rezidente gjenerohen rreth 6 ton mbetje ne dite ose 1052 ton/vit.Me nje frekuence grumbullimi 7 dite ne jave me nje turn/dite.
- Ne Njesine Adminsitrative Qender Bilisht gjenerohen 2.6 ton/dite ose 874 ton/vit me nje frekuence grumbullimi 2 here ne jave me dy turne ne dite.
- Ne Njesine Administrative Miras gjenerohen 3.0 ton/dite mbetje ose 1001 ton/vit me nje frekuence grumbullimi 2 here ne jave me dy turne ne dite.
- Ne Njesine Administrative Proger gjenerohen 1.8 ton/dite mbetje ose 604 ton/vit me nje frekuence grumbullimi 2 here ne jave me dy turne ne dite
- Ne Njesine Administrative Hocishtr gjenerohen 2.1 ton/dite mbetje ose 693 ton/vit me nje frekuence grumbullimi 2 here ne jave me dy turne ne dite.

Jjane kerkuar kerkuar 1 kamion me kapacitet 10 ton per Qytetin Bilisht dhe nga 1 kamion me kapacitet 5-8 Ton per njesite e tjera adminitrative Hocishti, Proger,Njesia Qender Bilisht dhe Miras.

Makina për larjen e rrugëve, (autobot) i pajisura me pompë për larjen e rrugëve me presion, me dy ose më shumë pjata larëse në pjesën e përparme, me kapacitet mbajtes jo më pak se 10,000 litra ujë, jo më pak se 1(një) copë. AK ka kerkuar vetem nje mjet per punimet e ketij sherbimi qe eshte ne perputhje me zerat ne preventiv

- Kamioncine 3-5 Ton -Ak ka kerkuar disponimin e nje mjete te tipit kamioncine per transportin e konteniereve te demtuar ne repartin mekanik per riparimin e tyre dhe pas riparimit dergimin e tyre ne objekt.

- Ak ka kerkuar dispononimin e nje mjet1 rezervë :1. Makinë teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës jo më pak se 10 ton, raport kompaktimi 1:4 - 1:6, 1 (një) copë në rast avarie

Numri dhe lloji i makinerive dhe paisjeve është vendosur duke ju referuar zerave te sherbimit sipas specifikimeve teknike, sipas grafikut te detajuar dhe kohëzgjatjes së sherbimit, Për të zbatuar kontratën, operatorët ekonomik duhet të përmbushin kapacitetet teknike të pajisjeve dhe aseteve të tjera fizike, për këtë janë përcaktuar edhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët. Nëpërmjet kapaciteteve teknike operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë aftësinë dhe kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative. Pajisje dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit pergjegjes për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës si dëshmi për mjetet dhe pajisjet sipas specifikave. Numri i mjeteve/makinerive që nevojiten për realizimin e kontratës është përcaktuar bazuar në zerat e sherbimit.

2.3.10 Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, operatorët ekonomikë duhet të kenë në dispozicion apo që mund t'i vihet në dispozicion për të përmbushur kontratën ambient me sipërfaqe jo më e vogël se 1000 m² e cila do të shërbejë si pikë për parkim për mjetet dhe të tjera.Për të provuar këtë duhet të paraqitet dokument I vlefshëm që vërteton pronësinë. Në rastin kur ambjenti merret me qira duhet të paraqitet kontratë e vlefshme qiraje dhe dokument I vlefshëm që vërteton pronësinë e

qiradhënësit. Kontrata e qirase duhet të jete e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontrates, objekt prokurimi).

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Ambienti me sipërfaqe jo më e vogël se 1000 m² e cila do të shërbejë si pikë për parkim për mjetet dhe të tjera. Për të provuar këtë duhet të paraqitet dokument I vlefshëm që vërteton pronësinë dhe piken ku do të jene mjetet ku sipas specifikimeve teknike i ve në dispozicion Ak vendodhjen e sakte të këtyre mjeteve në rast kontrolli të operatorit ekonomik. Për të zbatuar kontratën, operatorët ekonomik duhet të përmbushin kapacitetet teknike të pajisjeve dhe aseteve të tjera fizike, për këtë janë përcaktuar edhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët. Nëpërmjet kapaciteteve teknike operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë aftësinë dhe kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative.

2.3.11 Operatori ekonomik që paraqet ofertën duhet të disponojë një pike për larjen dhe dizinfektimin e kazaneve(lavazh) në pronësi apo me qera (në formën e kerkuar nga ligji, me çertifikatë pronësie nëse është në pronësi, me kontratë qeraje nëse është marrë me qera shoqëruar me dokumentacionin e përkatës. Kontrata e qirase duhet të jete e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontrates, objekt prokurimi).

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar për përmbushjen me sukses të kontrates AK kërkon që OE të disponojë një pike për larjen dhe dizinfektimin e kazaneve(lavazh) në pronësi apo me qera (në formën e kerkuar nga ligji, me çertifikatë pronësie nëse është në pronësi, me kontratë qeraje nëse është marrë me qera shoqëruar me dokumentacionin e përkatës, kjo kërkohet pasi i siguron AK që trajtimi i kazaneve do të bëhet në një vend të përshtatshëm që përmbush kërkesat e higjenes dhe mjedisit sepse ujrat e ndotura dhe lëndet që do të perdoren për dezinfektim kanë impakt të drejtperdrejte me mjedisin dhe shëndetin e banoreve dhe nuk mund të bëhen në hapsira publike të kudondodhura në territorin e Bashkisë Devoll.

2.3.12 OE duhet të disponojë një fadromë në pronësi ose me qera. Në rastin në pronësi OE duhet të paraqesë dokumentacionin e cila provon pronësinë ose në rastin me qera OE duhet të paraqesë kontratën e qerasë, dokumentacionin shoqëruar që provon pronësisë e qiradhënësit dhe të jetë me afat minimalisht sa afati i realizimit të kësaj kontrate.

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetdeklarimit sipas shtojcës 9 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Ak arsyeve që prania e nje mjeti te tille eshte i domosdoshem per ngarkimin ose mbledhjen e mbetjeve te ngurta te cilat nuk mund te behen me fuqi punetore. Për të zbatuar kontratën, operatorët ekonomik duhet të përmbushin kapacitetet teknike të pajisjeve dhe aseteve të tjera fizike, për këtë janë përcaktuar edhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët. Nëpërmjet kapaciteteve teknike operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë aftësinë dhe kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative. Pajisje dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit pergjegjes për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës si dëshmi për mjetet dhe pajisjet sipas specifikave.

2.3.12 Operatori ekonomik duhet të vërtetojë se ka të punësuar staf teknik për kryerjen e shërbimeve, si më poshtë:

- 7 (shtate) shoferë për makina teknologjike (për grumbullim mbeturinash)
- 32 (tridhjetë e dy) punëtorë pastrimi
- 1 Manovrator

Për punonjësit e mësipër, ofertuesi duhet të paraqesë:

- Kontratë individuale të punës të vlefshme
- Leje drejtimi, certifikate e aftësi profesionale/Patente Manovrimi nga DPSHTRR (për shoferët)

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetdeklarimit sipas shtojcës 9 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin”.

Argumentimi: “Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/c dhe 6 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Menyra perlllogaritjes se shofereve dhe punonjesve te pastrimit eshte bere duke u mbeshtetur ne Vkm 319 date 31.05.2018”Per miratimin e masave per kostot e menaxhimit te integruara te mbetjeve”

Shoferat :Sipas percaktimeve te pikes 1.3.3 Vkm 319 date 31.05.2018”Per miratimin e masave per kostot e menaxhimit te integruara te mbetjeve” te Një kombinim i zakonshëm është një shofer për makinë dhe dy operatorëve gjatë grumbullimit të mbetjeve. Në ekipe të mëdha ky program do të zvogëlonte numrin e operatorëve të nevojshëm për grumbullimin, duke reduktuar kostot. Numri i shoferëve dhe operatorëve mund të llogaritet duke marrë parasysh numrin e turneve për një kamion dhe kufizimin ligjor të orëve të punës në ditë dhe në javë.Nga sa me sipër per 5 mjete per grumbullimin e mbeturinave Ak ka vendosur kombinimin minimal te personelit pra 5 shofere dhe 5 punonjes mbeshtetes.

1 Shofer per drejtimin e mjetit tip autobot I cili do te kryeje procesin e larjes se rrugeve sipas preventivit dhe nje shofer per drejtimin e mjetit tip kamioncine e cila do te perdoret per transportin e konteniereve te demtuar ne repartin mekanik per riparimin e tyre dhe pas riparimit dergimin e tyre ne objekt.

Punonjesit e pastrimit jane perllogaritur duke u bazuar ne volumet e siperfaqeve qe do te pastrohen/oreve te punes dhe shpeshetine e pastrimit gjate nje jave .

Duke marre per baze normen ditore te nje punonjesi qe pastron prej 6000 m2(norma ditore e fshirjes me fshese 5600 m2 si dhe duke konsideruar ne llogaritje edhe zhvendosjen ne zone) ne procesverbalin e perllogaritjes se fondit limit rezulton nje numer mesatar punonjesish prej 32. Nga te cilet 12 punonjes per fshirjen e qytetit Bilisht,dhe 20 punonjes per fshirjen e rrugeve te zonave rurale dhe rrugeve te ngushta te lagjeve ne qytet.

Zona	Siperfaqja m2	Siperfaqe m2/puntor/dite	Dite pune	koef konvertimit diteve te punes	Puntore	Total
Bilishti	42400	6000	365	1.6	12	32
Lagjet/Qyteti	39859	6000	104	1	7	
Qender Bilisht	21425	6000	104	1	4	
Miras	20718	6000	104	1	3	
Proger	19978	6000	104	1	3	
Hocisht	17610	6000	104	1	3	

Pervec mjeteve teknologjike per grumbullimin e mbeturinave ak ka kerkuar edhe disponimin e nje mjete te tipit Fadrome per ngarkimin ose mbledhjen e mbetjeve te ngurta te cilat nuk mund te behen me fuqi punetore. Per drejtimin e ketij mjete Ak ka kerkuar pervec shofereve edhe 1 Manovrator.

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar sipas kërkesave të ligjit nr. 152/2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin” Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përkrahur nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”

Ak ka kerkuar qe Oe duhet të ketë në stafin e tij një mavovrator me leje drejtimi përkatëse dhe i siguruar pranë OE per mjetin e kerkuar ne piken 2.3.11. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

2.3.13 Operatori Ekonomik duhet te kete ne perberje te stafit Nje Mjek ne perputhje te plote me VKM nr.108 date 09.02.2011, i ndryshuar, te vertetuar me kontrate pune te vlefshme, diplome CV, leje ushtrimi profesioni te leshuar nga Urdheri i Mjekut.

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetdeklarimit sipas shtojcës 9 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

Argumentimi: Në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 108, datë: 09.02.2011 “Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në pune” i ndryshuar, njësia e prokurimit vlerëson se operatorët ekonomikë për sigurimin e jetës dhe shëndetit të punëmarrësve nëpërmjet zbatimit të masave të nevojshme, duhet të disponojnë si pjesë të stafit një mjek të përgjithshëm

2.3.15 Operatorët ekonomik ofertues duhet të kenë në stafin e tyre teknik të punësuar, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, certifikatat përkatëse dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë ofertuese, për periudhën (tre muajt e fundit) duke filluar nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës :

- Specialist të kualifikuar sipas formimit profesional për ngritjet manuale me dorë - minimalisht 1 (një).
- 1 (një) specialist për sistemin e menaxhimit të mbetjeve mjedisore/urbane

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetdeklarimit sipas shtojcës 9 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin

Argumentimi: Kërkesa per 1 Specialist të kualifikuar sipas formimit profesional për ngritjet manuale me dorë - minimalisht 1 (një) është përcaktuar bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” : Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Lidhur me kërkesën e autoritetit kontraktor për disponimin nga ana e ofertuesve të 1 (një) specialisti të kualifikuar sipas formimit profesional për ngritjet manuale me dorë, gjykon se për sa kohë në

preventivin e shërbimit është parashikuar mbledhja dhe transporti i mbejteve urbane në venddepozitimin e mbetjeve i cili do të kryhet me mjete teknologjike, specialisti i kërkuar nevojitet për afrimin e kontenerit dhe ngritjen e tij pranë mjetit teknologjik për shkarkimin e mbetjeve urbane. Për sa më sipër argumentuar, kërkesa e AK është në përputhje me objektin e kontratës nga ku procesi i mësipërm i punës nuk kryhet nga çdo punonjës, por kryhet nga persona të aftë dhe të trajnuar duke shmangur çdo rrezik të mundshëm.

Argumentimi : Kërkesa për 1 (një) specialist për sistemin e menaxhimit të mbetjeve mjedisore/urbane është përcaktuar bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” : Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Lidhur me kriterin e mësipërm njësia e prokurimit gjykon se duke marrë parasysh proceset e punës për këtë shërbim, operatori ekonomik fitues ka detyrimin e venddepozitimit të mbetjeve urbane, nevojitet (një) specialist për sistemin e menaxhimit të mbetjeve mjedisore/urbane, duke kryer proceset e sistemit të tyre në vendin e përcaktuar nga autoriteti kontraktor.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shënim:

Kandidati, ofertuesi i huaj duhet të vërtetojë se plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër. Operatorët e huaj ekonomikë duhet të paraqesin të gjithë dokumentacionin e tyre në gjuhën angleze si dhe t'i certifikojnë me vulën ”Apostille”. Për vendet që nuk e kanë ratifikuar Konventën e Hagës, datë 05.10.1961 për ”Heqjen e kërkesës për legalizim diplomatik e konsullor të dokumentave zyrtare të huaj”, duhet të bëhen legalizimet e ketyre dokumentave në ambasadat, konsullatat ose zyrat respektive nga vendi i origjinës. Mosparaqitja e dokumentacionit në këtë formë është kusht s’kualifikues.

Në rastin e moslëshimit në vendin e origjinës të dokumentave të kërkuara sipas kriterëve të mësipërme, në rastin e ofertuesve të huaj, do të paraqiten dokumenta të lëshuar sipas legjislacionit të vendit të origjinës ose të paraqiten dokumenta ekuivalente me to ose deklaratë me shkrim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Fondi limit, sasite, termat e references dhe specifikimet teknike janë hartuar nga grupi i punës i ngritur me urdhrin e Kryetarit të Bashkise Nr.283 date 27/06/2023 sipas procesverbalit të mbajtur prej tyre.

NJËSIA E PROKURIMIT